



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural

THIRRJE PËR APLIKIM

Thirrje për aplikim të fermerëve për përkrahjen e prodhueseve të Qumështit

Ftojme fermerët e Komunës së Prishtinës të aplikojnë për subvencione, pagesa direkte, për prodhim të qumështit.

Kriteret që duhet t'i plotësojnë fermerët/aplikuesit:

1. Të jenë banorë të komunës së Prishtinës dhe aktivitetin e tyre prodhues ta realizojnë në territorin e komunës së Prishtinës;
2. Të ofrojnë dëshmi të lëshuar nga laborator i AUV-së për cilësinë e qumështit, të dorëzuar në qumështore të licencuara ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
3. Të kenë kontratë të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara ose në ndonjërin nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
4. Të ofrojnë dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur;
5. Të kenë dorëzuar së paku 1,000 (një mijë) litra qumësht dhe më së shumti deri në 20,000 (njëzet mijë) litra qumësht për 6 (gjashtë) muaj;
6. Subvencionimi do të bëhet për litër qumësht të dorëzuar, brenda kornizave prej më së paku 1,000 (një mijë) deri në 20,000 (njëzet mijë) litra qumësht;

Dokumentacioni i kërkuar:

1. Kopja e një dokumenti identifikues të Republikës së Kosovës;
2. Konfirmimi nga banka për xhirollogarinë bankare;
3. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve (gjedhet, dhentë dhe dhitë), të lëshuar nga Sektori për identifikim dhe regjistrim në kuadër të AUV-së;
4. Vërtetimi nga Veterinari (kopje);
4. Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noter, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose në ndonjëra nga pikat e grumbullimit të qumështit si biznese, të cilat kanë kontratë me ndonjëren qumështore të licencuar;
5. Dëshmia për sasinë e qumështit të dorëzuar në qumështore ose në pikën grumbulluese të qumështit;
6. Dëshmia nga banka për sasinë e qumështit të shitur, për 6 mujorin e parë të vitit 2026;
7. Dëshmia për pjesëmarrjen në projektin “Transparenca dhe neutraliteti i marrjes së mostrave të qumështit” (e lëshuar nga projekti).

Aplikimi bëhet nga 18/08/2026 deri 03/09/2026, në objektin e bashkësisë lokale në Besi.